



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2022:155841

Datë: 11.09.2024

Numri i dokumentit: 06148742

**P.nr.342/22**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, bashkëpunëtores profesionale Gentiana Dakaj, në çështjen penale ndaj të pandehurave S. B. nga F. dhe A. B. nga F., të cilat i akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën saj PP.II.nr.1040/22 të dt.28.07.2022, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në shqyrtimin fillestar, publik, të mbajtur me datën 20.05.2024, në prani të prokurores së shtetit Nebahate Salihu, të pandehurave, ndërsa me dt.05.09.2024 mori dhe publikisht shpalli këtë:

### **A K T G J Y K I M**

Ndaj të pandehurave:

**1.S. B.**, e lindur me ... në fshatin R. K. R., me vendbanim në F. në Rr."R.", e bija e A. dhe N., e gjinisë H., ka të kryer shkollën e mesme, e gjendjes së mirë ekonomike, e martuar, Shqiptare, Shtetase e Republikës së Kosovës, më parë e pa dënuar, mbrohet në liri.

**2.A. B.**, e lindur me .. në P., me vendbanim në F. në Rr."R.", e bija e I. dhe S. e gjinisë H., ka të kryer fakultetin ekonomik, e gjendjes së mesme ekonomike, e pa martuar, Shqiptare, Shtetase e Republikës se Kosovës, më parë e pa dënuar, mbrohet në liri.

### **J A N Ë F A J T O R**

**Sepse:**

**S. B. dhe A. B.**

I.Me datë 07.03.2022 rreth orës 00:45 në fshatin V. e G., K. L., pas një mosmarrëveshje të mëhershme në mes të të pandehurave S. B. dhe A. B. në njërën anë dhe të pandehurës F. H. në anën tjetër, të pandehurat S. dhe A. B. kanë shkuar tek e shtëpia e F. H. dhe pas një fjalosje në bashkëkryerje dhe me dashje dhe me qëllim që ti shkaktojnë lëndime trupore të pandehurës F., të njëjtat e sulmojnë fizikisht të pandehurën F. duke e goditur me duar në pjesë të ndryshme të trupit, me ç'rast të njëjtës i shkaktojnë lëndime të lehta trupore dhe atë gërvishtje në regjionin e gjurit të djathtë të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretes (jo të mprehtë), me pasoja të përkohshme në shëndet,-

-Me këtë të pandehurat në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nënpar. 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të lartëcekura si dhe dispozitave të neneve 1, 2, 4, 6, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 46, 47, 48, 49, 50, 69 dhe neni 185 par.1 nënpar. 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPK-së, të pandehurave i shqipton:

### **DËNIM ME GJOBË DHE ME KUSHT**

Të pandehures së parë S. B. me dënim me gjobë në shumë prej prej 200.00-€ (dyqindeuro), të cilin dënim e pandehura detyrohet ta paguaj në afat prej 15 dite, nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënimi me gjobë, konform nenit 43 par.3 të KPRK-së do të zëvendësohet me dënim me burgim, për një ditë burgu do ti llogaritet shuma prej 20.-€.

Të pandehures se dytë A. B. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e pandehura në afat prej 1 vitesh nuk kryen veprë tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet.

**E dëmtuara:** F. H. nga fsh. V. K. L., udhëzohen që kërkesën pasuroro-juridike ta realizojnë në procedurë të rregullt civile.

**DETYROHEN** të pandehurat në mënyrë solidare ti paguajt shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të ekspertizës mjeko-ligjore të paguaj shumën prej 20-€, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20-€, si dhe shumën nga 20-€, në Fondin e Kompensimit të Viktimave të Krimin, të gjitha këto në afat prej 15 dite pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.1040/22 të dt.28.07.2022, i ka akuzuar të pandehurat S. B. nga F. dhe A. B. nga F., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së ndërsa F. H. nga fsh. V. K. L. për shkak të veprës penale nga neni 185 par. 1 nënpar.1.1 të KPRK-së.

Gjykata sipas aktvendimit të dt.05.09.2024 ka marrur aktvendim me të cilën është veçuar procedura penale ndaj të pandehurës F. H. nga fsh. V. K. L., pasi që e njëjta nuk ka qenë e arritshme për gjykatën.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajsisë pasi që pranimi i fajsisë ka mbështetje në shkresat e lëndës dhe është në pajtim me dispozitat e nenit 242 të KPPK-së, i ka propozuar gjykatës që ta pranojë pranimin e fajsisë dhe të pandehurat ti shpall fajtoresh dhe ti shqipton dënim meritore.

E pandehura e parë S. B. në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajsinë për veprën penale e cila i vihet në barr dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërit veprime të tilla, është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe shtoj se ajo që ka ndodhur me motrën time F. ka qenë e rastësishme e rastit për disa probleme që i kanë në familje, e ka lutur gjykatën që ti shqipton një dënim sa më të butë sepse ka qenë edhe e dëmtuar nga ajo.

E pandehura e dytë A. B. në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e ndihet fajtoresh për këtë veprim por ka shtuar se ajo që ka ndodhur ka qenë provokim i tezhës F. sepse sa ka qenë e martuar tek M. B. në fsh. V. të G. K. L. e njëjta ka tentuar që të më mer kundër vullnetit tim për djalin e ish burrit këtu M. i cili ka pasur djalin me një grua tjetër dhe mos marrveshjet këtu kanë filluar dhe se nëna ime ka qenë e lënduar nga F. ditën kritike për shkak kësaj gjendje tepër të rënduar pikërisht veprimet e F. tezes sime. Është e papunë po ashtu edhe nëna e saj dhe në gjendje jo të mirë shëndetësore nëna ime, e ka lutur gjykatën që ti shqipton një dënim sa më të butë.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se të pandehurat e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajsisë, ky pranimi i fajsisë është bërë në mënyrë vullnetare, pranimi i fajtit nuk është rrezultat i forcës, kërcënimeve apo premtimeve të kundërligjshme, pranimi i fajsisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk është e përfshirë në shkellje të qarta ligjore e as gabime faktike, konformë nenit 242 të KPPK-së, e pranoi pranimin e fajsisë nga ana e të pandehurave për veprën penale për të cilën akuzohen.

#### *Matja dhe caktimi i dënimit*

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehuren e parë S. B., gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform nenit 69 të KPRK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat para kryerjes së veprës penale, pra faktin se e njëjta për herë të parë ka rënd ndesh me ligjin, sjelljen pas kryerjes së veprës

penale pra, faktin se e njëjta është penduar për veprën penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritë sjellje të tilla, rrethanat personale dhe familjare pra faktin se e njëjta është mbajtëse e familjes dhe e gjendjes jo të mirë ekonomike, e veqanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale për të pandehuren, pra faktin se në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë e aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e veta inkriminuese dhe duke marr për bazë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, të njëjtes i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehuren e dytë A. B., gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform nenit 69 të KPRK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat para kryerjes së veprës penale, pra faktin se e njëjta për herë të parë ka rënd ndesh me ligjin, rrethanat personale dhe familjare se e njëjta është e moshës së re që lenë për të kuptuar se në të ardhmen mund të bëhet anëtare e dobishme e shoqërisë dhe e gjendjes jo të mirë ekonomike, sjelljen pas kryerjes së veprës penale pra, faktin se e njëjta është penduar për veprën penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritë sjellje të tilla e veqanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale për të pandehuren, pra faktin se në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë e aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e veta inkriminuese dhe duke marr për bazë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, të njëjtes i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 47 të KPRK-së.

*Vendimi për shpenzimet e procedurës*

Vendimi për shpenzimet e procedurës u bazua në nenin 449 dhe 450 të KPPK-së, ku shuma prej 20-€ u caktua në emër të paushallit gjyqësor në bazë të ndërlikshmërisë së rastit, ndërsa shuma prej 20-€ për Kompenzimin e Viktimave të Krimit u bazua në nenin 36 të Ligjit për Kompenzimin e Viktimave të Krimit si dhe shuma prej 20-€ në emër të ekspertizës mjekoligjore.

*Kërkesa pasurore-juridike*

Vendimi për kërkesën pasurore-juridike u bazua në nenin 462 të KPPK-së, dhe gjykata e udhëzoi të dëmtuarin që për realizimin e kërkesës pasurore juridike ta realizoj në procedurë të rregullt gjyqësore pasi që gjykata në këtë procedurë penale nuk ka pasur prova të mjaftueshme për të vërtetuar lartësia e dëmit të shkaktuar.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN**  
**P.nr.342/22 dt.05.09.2024**

**Bashkëpunëtorja profesionale**  
**Gentiana Dakaj**

**GJYQTARI**  
**Avdirrahman Gashi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 30 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2022:155841  
Datë: 11.09.2024  
Numri i dokumentit: 06148742